



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHENDETESISE
DHE E MBBROJTJES SOCIALE
QENDRA SHENDETSORE E SPECIALITETEVE NR.1
TIRANE**

Nr. ____Prot.

Tirane, me 01.06.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin” e ndare ne 4 (kater) lote

Loti 1. ”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Nihon Coden/ ose ekuivalent i tij”

Loti 2. ”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin klinik-biokimik”

Loti 3. ”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin biokimik per aparatn Kenza 240 ISE/ ose ekuivalent i tij”

Loti 4. ”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”

Fondi limit ne total eshte vleren 19 437 346 (nentembedhjete milion e katerqind e tridhjete e shtate mije e treqind e dyzet e gjashte) leke pa TVSH

Loti 1. me fond limit 3 729 950 (tre milion e shtateqind e njezet e nente mije e nenteqind e pesedhjete) leke pa tvsh.

Loti 2. me fond limit 1 848 163 (nje milion e teteqind e dyzet e tete mije e njeqind e gjashtedhjete e tre) leke pa tvsh.

Loti 3. me fond limit 5 326 333 (pesemilion e treqind e njezet e gjashte mije e treqind e tridhjete e tre) leke pa tvsh.

Loti 4. me fond limit 8 532 900 (tetemilion e peseqind e tridhjetë e dy mijë e nenteqind) leke pa tvsh leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor QSHS ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER TE 4 (KATER) LOTET:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Sipas vlerave të përcaktuara në Seksionin 3 të DST*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë për te 4 (kater) Lotet :

Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për “Tregtim me shumicë/pakice të pajisjeve mjekësore” mbeshtetur në nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 89/2014, datë 17.07.2014. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 89/2014, datë 17.07.2014 “Tregtim me shumicë/pakice të pajisjeve mjekësore”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020,2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit për të cilin oferton ose shumës se loteve që ofetohen.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2.2.2.Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3(tre) viteve të fundit 2019, 2020, 2021. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet

te paraqese kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit, ne te cilat duhet te rezultojë se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te nje pasnjeshem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale për te 4 (kater) Lotet:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit për të cilin oferton ose shumës së loteve që ofetohen.

Keto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur furnizime të mëparshme të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontraten e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.
ose
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, si dëshmi pranohen **vetëm fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Kërkohet deklarate e ofertuesit; për plotësimin e afatit të skadencës së tyre, si dhe respektimit të specifikimeve teknike të kërkuara nga shërbimi i Laboratorit për secilin artikull. Deklarate mbi afatin e skadencës së mallit të ofruar si më poshtë:

- HBA1C Skadencë të jetes sipas datës maksimale të skadencës të vendosur nga prodhuesi.
- Per Autoanalizatorin Hormonal, afati i skadencës për Kitet dhe Reagentet që nga data e levrimit të mallit të jetë jo më i vogël se 6 (gjashtë) muaj.
- Serumi i kontrollit të jetes i përshtatshëm për të gjithë reagentet me siper.
- Standartet për çdo metodë të jenë të përfshira në cmim.

- Data e skadencës në ditën e levrimit të mallit për artikujt e tjerë duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të sjellin mostra për çdo artikull një orë para përfundimit të afatit për hapjen e ofertave.
- *Data e skadencës duhet të jete e shënuar në ambalazhin e produkteve.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është konform VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Autorizim të leshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(*ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin*) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje për autoritetin kontraktorik specifik, materialet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbi kërkesën e autorizimit të prodhuesit është konform VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të leshuara direkt nga prodhuesi

2.4.3 Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, **dhe nese operatori ekonomik ofertues eshte prodhues** i pajisjeve mjekësore duhet të paraqese çertifikatën SSH EN ISO 13485:2016 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore “ose EN ISO 13485 :2016 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”.

Në rastet kur Operatori ekonomik ofertues, nuk është prodhues, duhet të paraqese një vetdeklarim që në këtë rast furnizuesi është konform standarteve të cilësisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të leshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë se i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.4.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autodeklarate për materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) per konformitetin me normat MDD 93/42/EEC ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes, bashkëlidhur me kopjet te certifikatave perkatese CE/DC (Deklarate konformiteti)/ FDA, origjinale, ose fotokopje te perkthyer.*

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 pika 2 , të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

2.4.5 Ofertuesi duhet te paraqese kataloge te markuar per mallrat objekt prokurimi, me te dhenat teknike ku te perfshihen edhe specifikimet teknike te hollesishme per secilin artikull. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofetuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 inxhinier te diplomuar ne profilin Inxhinieri Elektronike/ Elektrike/ Mekanike/ Informatike/ Mjekesore, gjithashtu te jete i trajnuar per pajisjet laboratorike pasi do te jete pergjegjes per instalim, trajnim te stafit mjekesore dhe kalibrimin e marterialeve. Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 paragrafet b dhe c) të

VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës i referohet pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për 1 (një) inxhinier të diplomuar në profilin Inxhinieri Elektronike/ Elektrike/ Mekanike/ Informatike/ Mjekesore, gjithashtu të jete i trajnuar për pajisjet laboratorike pasi do të jete përgjegjës për instalim, trajnim të stafit mjekesore dhe kalibrimin e marterialeve, lidhet me domosdoshmërinë për prezencën në stafin e OE të një profesionisti që është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të procesit. 1 (një) inxhinier, duke marrë parasysh kompleksitetin e kontratës, afatet kohore, shumëllojshmërinë e mallrave të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë e kërkesave të AK të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit.

2.4.7 Operatori/et ekonomik fitues janë të detyruar që të bëjnë kalibrimin e të gjitha kитеve dhe reagenteve që do të sjellin me pajisjet mjekesore që disponon Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr. 1 Tirane, për këtë të paraqesin një deklaratë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5, 6 të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4.8 Ne daten e hapjes se procedures , ne oren 08:00 ofertuesit duhet te paraqese, prane Laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1, mostra e artikujve qe prokurohen, per Komisionin e Vleresimit te Ofertave. Mostrat te jene te shoqeruara me nje liste inventari (procesverbal) te firmosur dhe vulosur, ku te pasqyroje detaje qe pershkruajne mostrat e administruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar Udhezimin nr. 03, date 12.04.2022 ”Mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga Operatoret Ekonomik”, sipas se ciles Autoriteti Kontraktor mund tu kerkoje operatoreve ekonomik te dorezoje mostra te mallit , objekt prokurimi. Paraqitja e mostrave eshte e rendesishme per vleresimin e aspektit teknik te ofertes, me qellim qe cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara.

2.4.8 Si kriter per Lotin nr. 3 Operatori ekonomik fitues duhet te sjelle pajisje mjekesore per kryerjen e analizes se Fibrinogjenit, e cila do te jete ne perdorim nga Qendra Shendetesore e Specialiteteve nr. 1 per nje afat 1 (nje) vjecar.

Per kete operatori ekonomik duhet te depozitoje nje deklarate, ku te deklaroje se i jep ne perdorim qendres pajisjen mjekesore Autoritetit Kontraktor deri ne mbarimin e kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne kerkesen e mjekeve te laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1, pasi nuk e disponojme nje pajisje te tille vetem per analizen e fibrinogjenit.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti 1

”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Nihon Coden/ ose ekuivalent i tij”

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasi
1	Isotonac 3 litra	18 kuti	16
2	Hemolynac 3N liter	1 shishe	6

3	Cleanac litra	5 shishe	6
4	Gjak kontroll normal	flakon	4
5	HbA1C per Nyco Card Alere ose ekuivalente por kontabel me aparat Nyco Card Alere	cope (1 kuti = 24)	6000
6	Maja te Bardha 10 µl	cope	5000
7	kyveta dhe zara per minivolt mono	cope	6000
8	Tromboplastine Calcike ISI 1	ml	2500

Loti 2

"Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin klinik-biokimik.

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasi
1	Stripe per urinen (1*100 cope)	kuti	50
2	Lama (1*50 cope)	kuti	60
3	Lamela 24*50 mm	kuti	5
4	Giemsa	litra	5
5	Tuba urine (konike)	cope	2500
6	Set (tuba sedimenti + Pipetasedimenti) 1 ml max ESR	cope	6000
7	Tuba K3 EDTA 1 ml	cope	22000
8	Tuba me xhel	cope	45000
9	Tuba me citrat Na 2.5 ml max	cope	20000
10	Pipeta automatike 10-100	cope	1
11	Pipeta automatike 100- 1000	cope	1
12	Maja blu	cope	1000
13	Maja te verdha	cope	10000
14	Tuba te thjeshta per analiza 5ml	cope	20000
15	Kontenitore urine sterile	cope	200
16	Metanol	litra	1

17	Acid Nitrik 1 kg + filter (krip distilator)	liter	1
18	Parafil (Roll 100 MM X 38 MT)	cope	1
19	Vaj cedri (ose vaj immersioni)	100 ml	3
20	Solucion Brillant Cresyl Blue (per Retikulocit)	100 ml	4
21	Xham shtrires	kuti	1
22	Tuba qelqi (per hollimin e urines)	cope	10
23	Pipeta qelqi te shkallezuara (deri 5 ml)	cope	5
24	Cilinder te shkallezuar (deri 100 ml)	cope	3
25	Acid sulfosalicilik	kg	1
26	Tampon per sekrecion vaginal (Steril)	cope	100
27	Set per fece gjak okult	cope	600

Loti 3

”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin biokimik per aparatn Kenza 240 ISE/ ose ekuivalent i tij”

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasi
1	Glucose GOD -PAP	ml	4000
2	Cholesterol CHOD-PAP	ml	2600
3	Trglycerides GPO-PAP	ml	3000
4	Urea UV HIGH KINETIK METOD	ml	5300
5	ALT (SGPT) TGP/FCC	ml	4080
6	AST (SGOT)	ml	4080
7	Bilirubine Totale DCA METHOD	ml	4000
8	Bilirubine Directe DCA METHOD	ml	1000
9	Creatinine KINETIK METOD	ml	2500

10	Alkaline Phosphatase (ALP) DEA	ml	2880
11	GGT CARBOXY GPNA	ml	1200
12	Iron DIRECT METHOD	ml	500
13	Acid Uric URIOSE METHOD	ml	2400
14	Calcium CPC METHOD	ml	4000
15	Alpha Amylase CNPG	ml	300
16	ASO Turbidimetri Imunosei	tests	4000
17	Kalibrator ASO	KUTI	2
18	CRP Turbidimetri Imunosei	tests	7000
19	Kalibrator PCR	kuti	2
20	FR Lateks (test i shpejte)	tests	7000
21	Serum kontrolli Exatrol P	kuti (10x5 ml)	2
22	Serum kontrolli Exatrol N	kuti (10x5 ml)	5
23	Proteine totale ready to use (Biuret)	ml	2000
24	Multi calibrator	kuti (10x5 ml)	2
25	HITACHI TUBES 1000ML (Kenza 240 ISE ose ekuivalente por kontabel me aparatin Kenza 240 ISE)	pako (1*1000)	25
26	IPOCLEANING SOLUTION	KUTI	6
27	Extra Cleaning	KUTI	6
28	Reference Elektrode	KUTI	1
29	Na Elektrode	cope	1
30	K Elektrode	cope	1
31	Cl Elektrode	cope	1
32	Reagent Pack ISE	kuti	6
33	Cleaning Solution -ISE	kuti	6
34	M Kit 1	kuti	4
35	M Kit 2	kuti	2
36	Reagent Containers - Monoreagent - K240 / 50 PCS	kuti	1

37	Reagent Containers - Bireagent - K240 / 50 PCS	kuti	1
38	00360 STA Owren Koller	kuti 24x15 ml	3
39	00673_SP STA Liquid fib	kuti 12x4 ml	8
40	00621 coag control N+P	kuti 12x2x1 ml	1
41	00625 Unicalibrator	kuti 6x1 ml	1
42	0026441 Balls Vial	kuti 1850 Billes	5
43	0038876 Cuvettes	kuti 150x4 CUV	14

Loti 4

”Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasi
1	TSH 1*100 teste	Kuti	47
2	FT3 1*100 teste	Kuti	5
3	FT4 1*100 teste	Kuti	30
4	ANTI TPO 1*100 teste	Kuti	20
5	FERRITINE 1*100 teste	Kuti	25
6	PSA 1*100 teste	Kuti	12
7	HbsAg 1*50 teste	Kuti	1
8	Starter 1+2	1box x3	25
9	Wash liquid	bidon	30
10	Reaction modules	kuti	20
11	Light check (1*5flakon)	kuti	10
12	Tubing solution	bidon	1
13	CA 15-3 (1* 50 teste)	kuti	10
14	CEA (1*50 teste)	kuti	15
15	CA 125 (1*50 teste)	kuti	5
16	CA 19/9 (1*50 teste)	kuti	7
17	Vitamin D3 1*50 teste	kite	27
18	Maglum D-Dimer	kuti (teste 1 X 100)	20

Afatet e lëvrimt:

Afati i levrimit per kitet dhe reagentet te jete nga momenti i lidhjes se kontrates deri me date 31.12.2023 si dhe te realizohen sipas kerkesave dhe nevojave te laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës dhe anëtar i njësisë së prokurimit.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK: